




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Kandidatët pjesëmarrës për aplikim për licencë të KPM-së, në bazë të konkursit të shpallur më 15 shkurt 2019, për Komunën e Prishtinës:

Kandidati: N.SH. "Infokusi"

Nr. unik identifikues: 810202292

Pronar: znj. Valdete DAKAJ

Emri i propozuar: Radio Focus

Adresa: Rr/Beqir Kastrati, Ob.2 Nr. 29
Prishtinë

Kodi i kandidatit: R1

Kandidati: "Criteria Netëork" SH.P.K.

Nr. i biznesit: 71155986

Përfaqësuar nga: z.Blerim KROMA

Emri i propozuar: Radio Criteria

Adresa: Mati 1, Lin Projekt, Hyrja 8, Nr.41
Prishtinë

Kodi i kandidatit: R2

Kandidati: "Inntegra" L.L.C.

Nr. unik identifikues: 810875495

Pronar: z. Menduh LLUKA

Emri i propozuar: Radio Club FM

Adresa: Rr/ Isa Kastrati, Nr. 1
Prishtinë

Kodi i kandidatit: R3

Kandidati: "Positive Gold" SH.P.K.

Nr. i biznesit: 810109761

Pronar: Astrit DUHSI

Emri i propozuar: Radio Positive Gold FM

Adresa: L.Spitali-Holger Pedersen II/11
Prishtinë

Kodi i kandidatit: R4

Kandidati: " Universiteti AAB" SH.P.K. .

Nr. unik identifikues : 810478299

Përfaqësuar nga: Gëzim SHABANI

Emri i propozuar: Radio AAB

Adresa: Zona Industriale
Prishtinë

Kodi i kandidatit: R5

Kandidati: "Paper Media" SH.P.K.

Nr. unik identifikues : 810831356

Përfaqësuar nga: z. Berat MIFTARI

Emri i propozuar: City Radio

Adresa: Perandori Justinian, sol 1/6
Prishtinë

Kodi i kandidatit: R6

Ref: 1905/592/LIC/ni

VENDIM

për licencimin e kandidatit R3, për transmetim të radio programeve, me mbulim që i përket kategorisë regjionale, në Komunën e Prishtinës

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit.

KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

2. Në bazë të Ligjit nr. 04/L-44 (Ligji për KPM), neni 3, paragrafi 2.1. të, KPM licencon transmetuesit publik e privat dhe i ripërtërin licencat, duke iu dhënë subjekteve të autorizuar të drejtën e përdorimit të frekuencave në Spektrin e Frekuencave të Transmetimit si dhe licencon të gjitha shërbimet mediale audiovizuale.
3. Neni 3, paragrafi 2.6. i ligjit për KPM, i jep kompetencë dhe e obligon KPM-në që të nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat shërbejnë për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
4. Në pajtim me nenin 23, paragrafi 1 i Ligjit për KPM, më 15 shkurt 2019, KPM ka shpallur konkurs publik për dhënien e licencave të reja për transmetim të programeve në radio, për Komunën e Prishtinës. Konkursi publik ka qenë i hapur deri më 15 mars 2019.
5. Pas përfundimit të afatit për aplikim me 15 mars 2019, KPM, në takimin e datës 21 mars 2019, ka marr vendim për shtyrjen e afatit për aplikim edhe për 15 ditë, ndërsa, afati për aplikim ka qenë i hapur nga data 27 mars 2019 deri më datën 12 prill 2019.
6. Konkursi publik është zhvilluar mbi bazën e akteve nënligjore të KPM-së, të nevojshme për plotësimin dhe parashtrimin e aplikimit për licencë të KPM-së që janë 1. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM-2017/02); 2. Rregullorja për vlerësimin e aplikacioneve (KPM-2014/02) dhe 3. Rregullorja për Tarifën Vjetore për Licencë (KPM-2017/06).
7. Me datën 15 mars 2019, kandidatët, R1, R2, R3, R4, kanë dorëzuar aplikacionet e kompletuar në KPM, në pajtim me konkursin publik. Ndërsa, kandidati R5 ka dorëzuar aplikacioni brenda afatit për aplikim, mirëpo, jo të kompletuara në KPM, në pajtim me konkursin publik. Kandidati R6 nuk e ka dorëzuar aplikacionin e kompletuar në KPM, brenda afati për aplikim dhe në pajtim me konkursin publik.

Arsyetim

8. Vendimi i KPM-së për dhënien e licencave të reja është bërë mbi bazën e nevojave të publikut dhe kapaciteteve të lira frekuencore në ato komuna të Republikës së Kosovës, ku është vlerësuar se ka mungesë të shërbimeve mediale radio me mbulim lokal, si dhe në ato komuna ku është kërkuar që të krijohet mundësi për pluralizëm medial.
9. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit për KPM, thekson se: *“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
10. Në takimin e mbajtur më 23 prill 2019, Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve ka konstatuar se, aplikacionet kandidatëve R1, R2, R3, R4, janë dorëzuar të kompletuara në KPM dhe në pajtim me Rregulloren KPM-2017/02, duke i plotësuar në tërësi kushtet kualifikuese për licencë të KPM-së.

11. Në takimin e mbajtur më 23 prill 2019, Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve ka konstatuar se, aplikacionet kandidatëve R5 dhe R6, nuk janë dorëzuar të kompletuar në KPM dhe në pajtim me Ligjin për KPM dhe Rregulloren KPM-2017/02, duke mos arritur të t'i plotësojnë në tërësi kushtet kualifikuese për licencë të KPM-së.
12. Komisioni konstaton se, kandidati R5 nuk ka arritur që si pjesë e aplikacionit për licencë të KPM-së për radio ti dorëzoj deklaratat, për pronarin, me anë të cilave dëshmon se ai nuk mbanë poste të larta publike apo shtetërore, nuk është pjesë e strukturave udhëheqëse/ekzekutive të ndonjë partie politike apo nuk është pjesë e strukturave udhëheqëse/ekzekutive të ndonjë organizate fetare, ku sipas Ligjit për KPM-në, këtyre personave të cilët mbajnë pozita si ato të cekura më lart nuk do të ju lëshohet licencë e KPM-së.
13. Komisioni konstaton se, kandidati R5 nuk ka arritur që si pjesë e aplikacionit për licencë të KPM-së për radio të dorëzojë dëshmi nga gjykata themelore se ndaj pronarit nuk është duke u zhvilluar procedurë penale pranë kësaj gjykate.
14. Komisioni kandidati R6 nuk ka arritur që si pjesë e aplikacionit për licencë të KPM-së për radio të dorëzoj brenda afatit për aplikim dëshmi mbi kualifikimin superior (kopjen e noterizuar të diplomës) të personit përgjegjës për çështje teknike.
15. Neni 22, paragrafi 4, pikat: 4.1, 4.2, 4.3, 4.4 dhe 4.5 të Ligjit për KPM-në, përcakton kriteret kryesore mbi bazën e të cilave KPM vlerëson aplikacionet e kandidatëve për dhënien e licencës së KPM-së.
16. Komisioni për Vlerësim të aplikacioneve, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara sipas nenit 22, paragrafi 4 të ligjit të KPM-së, si dhe në bazë të Rregullores KPM-2014/02, ka vlerësuar kandidatin R1 me 32 pikë për *Kapacitetin për Zhvillimin e Programit Vetanak dhe Nevojën për të Siguruar Program të Shumëllojshëm për të gjithë Qytetarët në atë Zonë të Mbulimit*; me 20 pikë për *Kushtet Teknike* dhe me 30 pikë për *Qëndrueshmërinë Financiare*.
17. Komisioni konstaton se kandidati R1 ka grumbulluar gjithsej 82 pikë gjatë vlerësimit të kriterëve profesionale të përcaktuara me ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
18. Komisioni për Vlerësim të aplikacioneve, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara sipas nenit 22, paragrafi 4 të ligjit të KPM-së, si dhe në bazë të Rregullores KPM-2014/02, ka vlerësuar kandidatin R2 me 30 pikë për *Kapacitetin për Zhvillimin e Programit Vetanak dhe Nevojën për të Siguruar Program të Shumëllojshëm për të gjithë Qytetarët në atë Zonë të Mbulimit*; me 25 pikë për *Kushtet Teknike* dhe me 25 pikë për *Qëndrueshmërinë Financiare*.
19. Komisioni konstaton se kandidati R2 ka grumbulluar gjithsej 80 pikë gjatë vlerësimit të kriterëve profesionale të përcaktuara me ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
20. Komisioni për Vlerësim të aplikacioneve, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara sipas nenit 22, paragrafi 4 të ligjit të KPM-së, si dhe në bazë të Rregullores KPM-2014/02, ka vlerësuar kandidatin R3 me 36 pikë për *Kapacitetin për Zhvillimin e Programit Vetanak*

dhe Nevojën për të Siguruar Program të Shumëllojshëm për të gjithë Qytetarët në atë Zonë të Mbulimit; me 20 pikë për Kushtet Teknike dhe me 30 pikë për Qëndrueshmërinë Financiare.

21. Komisioni konstaton se kandidati R3 ka grumbulluar gjithsej 86 pikë gjatë vlerësimit të kriterëve profesionale të përcaktuara me ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
22. Komisioni për Vlerësim të aplikacioneve, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara sipas nenit 22, paragrafi 4 të ligjit të KPM-së, si dhe në bazë të Rregullores KPM-2014/02, ka vlerësuar kandidatin R4 me 18 pikë për *Kapacitetin për Zhvillimin e Programit Vetanak dhe Nevojën për të Siguruar Program të Shumëllojshëm për të gjithë Qytetarët në atë Zonë të Mbulimit; me 15 pikë për Kushtet Teknike dhe me 20 pikë për Qëndrueshmërinë Financiare.*
23. Komisioni konstaton se kandidati R4 ka grumbulluar gjithsej 53 pikë gjatë vlerësimit të kriterëve profesionale të përcaktuara me ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
24. Komisioni vlerëson se, kandidati R3 ka paraqitur aplikacionin për licencë të KPM-së më të detajuar dhe më të qartë, duke e mbështetur edhe në dëshmi të qëndrueshme për të themeluar një radio stacion që do të jetë në shërbim të qytetarëve të komunës së Prishtinës.
25. Kandidati R3 ka ofruar materiale të nevojshme dhe të mjaftueshme, për të qenë në përparësi me kandidatët tjerë, për t'u pajisur me Licencë të KPM-së, duke vepruar në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, si dhe me konkursin publik për frekuenca të lira, të shpallur më 15 shkurt 2019, nga KPM.
26. Komisioni vlerëson se, kandidati R3 ka përmbushur kriteret kualifikuese për t'u pajisur me licencë të KPM-së, në pajtim me Ligjin e KPM-së, me Rregulloren KPM-2017/02, duke grumbulluar gjithsej 86, pikë për sa i përket plotësimit të kriterëve profesionale për licencë të KPM-së, në pajtim me Rregulloren e KPM-2014/02.
27. Vlerësimi i aplikacioneve është bërë mbi bazën e metodës krahasuese, duke u bazuar në aplikacionin më të kompletuar sipas ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së.

VENDIM

28. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 17 maj 2019, merr vendim që, kandidatëve R5 dhe R6 t'u REFUZOJË kërkesat për licencë të KPM-së, mbi bazën se nuk kanë arritur që t'i plotësojnë në tërësi kushtet kualifikuese për licencë të KPM-së.
29. Komisioni, merr vendim që, kandidatëve R1, R2 dhe R4 t'u REFUZOJË kërkesat për licencë të KPM-së, mbi bazën e pikëve të pamjaftueshme të grumbulluara gjatë vlerësimit të aplikacionit.
30. Komisioni, merr vendim që, kandidatit R3 t'i APROVOJË kërkesën për licencë të KPM-së, mbi bazën e pikëve të mjaftueshme të grumbulluara gjatë vlerësimit të aplikacionit (86 pikë), për t'u pajisur me licencë të KPM-së për të vepruar si shërbim mediale audio,

duke ofruar programe radiofonike me interes publik për qytetarët në Komunën e Prishtinës.

31. Kandidatit R3 i lëshohet licenca e KPM- me mbulim që i përket kategorisë regjionale.

32. Përcaktimi i parametrave teknik si dhe caktimi i frekuencës që do të shfrytëzohet nga kandidatit R3 , të përcaktohen në Tabelën Teknike të Pakos së Licencës së KPM-së, pas marrjes së vendimit për licencim nga Komisioni.

E drejta për Ankesë

33. Kandidatëve: R1, R2, R4, R5 dhe R6, në bazë të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave (Ligji nr. 04/L-44), ju njihet e drejta e ushtrimit të ankesës ndaj këtij vendimi.

34. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

35. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

36. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të tij.


Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



17.05.2019
datë